



Primit / Dorezuar Prilidheni/Prodato Received/Delivety	22.12.2022	2	viti god year
Organ /Nisma Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtopa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/MSHCK	8369/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.974/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.947/2022 të datës 04.11.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rruga [redacted] në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.112-975 të datës 01.11.2022 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.12.2022, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.974/2022 e datës 04.11.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.112-975 i datës 01.11.2022 i Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën "Zyrtare e lartë për Informim" në Divizionin për Komunikim Publik, sipas Ndryshim plotësimit të Akt Emërimit të datës 18.06.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja [REDACTED] është e punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Ndryshim Plotësimit të Akt emërimit të datës 31.12.2015 në pozitën "Zyrtare për informim" në Divizionin për Komunikim dhe Informim.

Me datën 01.11.2022, Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka nxjerrë Vendimin Nr.112-975 sipas së cilës ankuesen nga pozita "Zyrtare e lartë për informim" në Divizionin për Komunikim me Publikun, e ka transferuar përkohësisht në pozitën "Zyrtare e lartë për zhvillim të dokumenteve strategjike" në Divizionin për Koordinim të Politikave në kuadër të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave nga data 01.11.2022 deri më 31.01.2023.

E pakënaqur me vendimin për transferim nga ana e Zëvendësueses së Sekretares së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ankuesja me datën 04.11.2022 fizikisht ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6703/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se nuk qëndron fakti që pozita për të cilën është transferuar është pozitë e lirë, përderisa në divizionin për komunikim me publikun është një zyrtar, e njëjta pretendon po ashtu se në pozitën për të cilën është transferuar nuk i plotëson kushtet për shkak të kualifikimit të cilin e posedon si bachelor dhe master i komunikimit publik dhe se sipas saj e njëjta është transferuar pa pëlqimin e saj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.11.2022 ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli, me datën 16.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 15.12.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.193/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses [REDACTED] edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 04.11.2022 me numër protokollit 6703/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.112-975 të datës 01.11.2022 lidhur me transferimin e ankueses; E-mailat zyrtar të datës 01.11.2022; Vendimin me numër Nr.112-519/2 të datës 16.07.2020 lidhur me transferimin e ankueses; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 18.06.2019; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 31.12.2015; Diplomën e ankueses me numër Nr.023/07 të datës 24.09.2004 nga Fakulteti i Komunikimit Masiv të AAB-së për studimet themelore; Diplomën e ankueses me numër Nr.516/21 të datës 23.04.2021 nga Fakulteti i Komunikimit Masiv të AAB-së për studimet master; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 16.11.2022 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal së bashku me

shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës të datës 24.11.2022 si Vendimin me numër VK.nr.193/2022 të datës 15.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të Vendimit me numër Nr.112-975 të datës 01.11.2022, i nxjerrë nga Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me transferimin e përkohshëm të ankueses, ka konstatuar se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil gjegjësisht sipas nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë sipas së cilës është përcaktuar se: *“Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”*, dhe se nga këto dispozita ligjore vërtetohet se në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë njësi përgjegjëse konsiderohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, andaj edhe vendimi lidhur me transferimin e përkohshëm të ankueses, është nxjerrë nga personi jo kompetent konkretisht nga Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal e jo nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të këtij institucioni, prandaj vendimi si i tillë është i kundërligjshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu pas analizimit të Vendimit me numër Nr.112-975 të datës 01.11.2022, i nxjerrë nga Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me transferimin e përkohshëm të ankueses, ka konstatuar se vendimi i atakuar me ankesë nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrativ, konkretisht nuk përmban saktë këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Akti administrativ i shkruar përmban.....: 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”*, kështu që nisur nga ky konstatim, vendimi si i tillë edhe në këtë kuptim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të këtij ligji dhe si i tillë është i kundërligjshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës si dhe ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka konstatuar se bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së ankueses del se pozita “Zyrtare e lartë për koordinim, planifikim dhe komunikim me media”, në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie të cilën e mban ankuesja, tek fusha e përgatitjes profesionale të arsimit kërkohet: *“Diplomë universitare në gazetari apo në ndonjë fushë tjetër të ngjashme që lidhet me marrëdhëniet me publikun, ndërsa në pozitën si “Zyrtare e lartë për zhvillim të dokumenteve strategjike”, në Divizionin*



për Koordinim të Politikave, në kuadër të Departamentit për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave, në të cilën ankuesja është sistemuar përkohësisht dhe është caktuar të kryej punët dhe detyrat nga kjo pozitë bazuar në përshkrimin e detyrave të punës, tek fusha e përgatitjes profesionale të arsimit kërkohet: *"Diplomë universitare në Juridik, Ekonomik dhe Administratë Publike"*, e që në bazë të provave të lëndës të bashkangjitura nga organi i punësimit, ankuesja posedon diplomën *Bachelor i Komunikimit Masiv* si dhe diplomën e studimeve *Master i Shkencave në Komunikim Masiv dhe Gazetari*. Ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson se për pozitën si *"Zyrtare e lartë për zhvillim të dokumenteve strategjike"*, në të cilën ankuesja është autorizuar lidhur me kryerjen e punëve dhe detyrave, nëpunësi duhet të jetë me kualifikim nga fusha e drejtësisë, ekonomisë dhe administratës publike e jo nga fusha e komunikimit dhe në këtë kuptim, realisht edhe nëpunësi i cili e ushtron këtë pozitë duhet të përmbaj edhe diplomën nga kjo fushë bazuar në përshkrimin e detyrave të punës sipas përshkrimit të lartcekur, andaj edhe pretendimi i ankueses ndërlidhur me këtë pjesë është i bazuar dhe ligjor.

Bazuar në këtë fakt të lartshënuar, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përgatitja profesionale e ankueses nuk është e përshtatshme me përgatitjen profesionale respektivisht përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën është caktuar me transfer, Kolegji vlerëson se për rastin konkret të ankueses nuk është bërë analizë e saktë e plotësisht të kushteve lidhur me sistemimin e ankueses dhe autorizimin e kryerjes dhe detyrave për një pozitë tjetër për ankuesen, andaj në këtë kontekst Kolegji vlerëson se Vendimi i Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me numër të protokollit Nr.112-975 të datës 01.11.2022, për sistemimin e ankueses për kryerjen e detyrave për pozitën si *"Zyrtare e lartë për zhvillim të dokumenteve strategjike"* është në kundërshtim me këtë frymë dhe poashtu nuk është në interes të institucionit në këtë kuptim.

Andaj, bazuar si me lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin Nr.112-975 të datës 01.11.2022 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthej ankuesen në pozitën *"Zyrtare e lartë për informim"* në Divizionin për Komunikim Publik, sipas Ndryshim Plotësimi të Akt Emërimit të datës 18.06.2019, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.947/2022, datë 22/12/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses ,
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.